# MANUALI I PËRDORIMIT



TebMobile

# PËRMBAJTJA



## HYRJE

## BUTONËT E SHËRBIMEVE SHTESË

Lokacionet e ATM/Degëve
Kalkulatori - Valuta, Depozita, Kredi, Kampanjat, Lajme & Ngjarje
Smart Key, Kontaktoni

Faqet 11-13 **1**

**KYQJA NË TEBMOBILE**

Faqe 15 **2**

**MONITORIMI I LLOGARIVE**

Faqet 17-23 **3**

**KREDIT KARTELA (STARCARD)**

Faqet 25-27 **4**

**MONITORIMI I KREDISË**

Faqet 29-37 **5**

**PAGESAT**
Pagesat Institucionale
Pagesa e Kolektorëve
Shërbimet e parapaguara
Mbushje e Telefonit përmes Debit Card/Starcard
SMS-Top up mbushje

Faqet 39-43 **6**

**TRANSFERE**
Transfere në llogaritë e TEB-it
Transfere në bankat vendore

Faqet 45-47 **7**

**PAGESAT AUTOMATIKE**

Faqet 49-51 **8**

**INVESTIME (BLERJE/SHITJA E VALUTËS)**

Faqet 53-54 **9**

**INFORMATA PERSONALE**



# HYRJE

• Produkti i veçantë i **Bankës TEB** ju ofron të gjitha shërbimet bankare online në telefonin tuaj.

Është i lehtë për përdorim, i sigurt, efektiv dhe në çdo kohë ju ofron qasje në llogari dhe produkte bankare.

• **Aplikacioni TebMobile** është në dispozicion për sistemet operative të telefonave të mençur **IOS** e **Android** dhe mund të shkarkohet falas në **App Store** apo **Play Store.**

• **TebMobile** është në dispozicion në dy gjuhë: **Shqip dhe Anglisht.**



· **Shërbimet Bankare** të cilat mund t'i kryeni përmes **TebMobile** janë:

- Monitorimin e llogarisë
- Pagesa dhe monitorimi i Kredit Kartelës
- Transferet nga llogaritë
- Pagesat e faturës së rrymës
- Pagesat automatike
- Verifikimi i numrit të telefonit mobile
- Mbusheni telefonin tuaj përmes StarCard
- Paguani TV dhe Internetin

# Butonët e shërbimeve shtesë

Në faqen kryesore të aplikacionit TebMobile, para se të kyqeni, në pjesën e poshtme shfaqen edhe këto butona të shërbimeve shtesë:

- **Lokacionet e ATM/Degëve**
- **Kalkulatori**
- **Kampanjat**
- **Lajme & Ngjarje**
- **SmartKey**
- **Kontaktoni**

01 Kryefaqja për tu kyqur



# Lokacionet e ATM/Degëve

Duke prekur në këtë buton do të hapet menyja ky tregon të gjitha lokacionet në Kosovë të **ATM-ve** dhe **Degëve të bankës TEB**. Duke klikuar në opsioni **Dega** do të shfaqen **lokacionet e Degëve të bankës TEB**, ndërsa duke klikuar në opsioni **ATM** do të shfaqen **lokacionet e ATM të bankës TEB.**

**01** Lokacionet e ATM-ve




**02** Lokacionet e Degëve



# Kalkulatori - Valuta

Duke prekur në butonin **Kalkulatori** shfaqet menyja me opsionin **Valuta,** këtu mund te përdorni kalkulatorin për konvertim të valutave nga **EUR në USD; CHF; GBP** dhe anasjelltas. Çfarë duhet të bëni është të zgjedhni valutën që keni në opsionin *valutën që kam*, dhe poshtë saj të shkruani shumën. Pastaj, duke zgjedhur valutën që dëshironi në opsionin *valutën që dua*, poshtë saj do të shfaqet shuma e konvertuar në valutën e dëshiruar.

**01** Kalkulatori
Opsioni: Valuta



# Kalkulatori - Depozita

Në opsionin tjetër **Depozita** ju mund të kalkuloni sa interes do të përfiton në rast të deponimit së një shume të caktuar, brenda një afati të caktuar kohor.
Çfarë duhet të bëni është të shkruani vlerën në kutinë **Shuma e deponura,** si dhe në kutinë **Periudha (muajt),** te shkruani afatin kohor në të cilin dëshironi t'i depononi mjetet në bankë. Duke prekur opsionin **Llogarit në Bilanci Final** do të shfaqet shuma së bashku me interes, pas zbritjes së normës së **Tatimit.**

**02**

Kalkulatori
Opsioni: Deposita



# Kalkulatori - Kredi

Opsioni i tretë në menynë Kalkulatori është **Kredi,** këtu ju mund të llogaritni **Totalin për pagesë të kredisë.** Çfarë duhet të bëni është të shkruani vlerën në kutinë **Shuma,** numrin e kësteve në bazë mujore në kutinë **Numri i kësteve,** dhe normën vjetore të interesit të pjestuar me **numrin 12** në kutinë **Norma mujore e interesit.**

Duke prekur opsionin **Llogarit,** ndër të tjerash do të shfaqet **Shuma Mujore, Interesi Total, si dhe Totali për pagesë.** Pastaj duke prekur opsionin **Apliko,** do të shfaqet menyja për të aplikuar për kredi, ku duhet të plotësoni të dhënat personale, si dhe pasi të keni aplikuar ju do të informoheni nga dega juaj për kushtet e tjera të cilat duhet të plotësohen për të përfunduar aplikimin.

**03** Kalkulatori
Opsioni: Kredi



# Kampanjat, Lajme & Ngjarje dhe Smart Key

**01** Kampanjat aktive

**02** Lajmet dhe Ngjarjet e Bankës

**03** Smart Key










Në këtë opsion ju mund të informoheni për kampanjat aktive të bankës TEB.

Në këtë opsion ju mund të informoheni për Lajmet dhe Ngjarjet e bankës TEB.

Në këtë opsion ju mund të validoni TebMobile tuaj në e-banking duke prekur butonin Kontrollimi për konfirmim, si dhe të riaktivizoni Smartkey tuaj duke prekur fjalën Riaktivizimi.

# Kontaktoni

Duke prekur butonin kontaktoni ju mund te jepni komentin ose ankesën tuaj, duke preku butonat **Komenti ose Ankesa** dhe të dërgoni mesazhin tuaj duke prekur kutinë **Dërgo mesazhin tuaj.** Ju duhet vetëm që përveq komentit/ankesës të plotësoni të dhënat tuaja. Gjithashtu duhe klikuar në kutinë **Na telefononi,** ju mund të kontaktoni direkt **Qendrën e Thirrjeve.**

**01** Plotësoni të dhënat dhe shkruani komentin/ ankesën tuaj.




**02** Telefononi Qendrën e Thirrjeve





# 1.Kyçja në TebMobile

Për kyçje në TebMobile fillimisht duhet të shkarkoni aplikacionin në telefonin tuaj nga App store ose Play store, pastaj të vizitoni degën me të afërt të TEB bankës dhe të aktivizoni produktin. Nga zyrtarët e bankës do t'iu ipet ID-ja e shfrytëzuesit. Pasi të keni marrë ID të shfrytëzuesit duhet të ndiqni këto katër hapa deri tek kyçja në aplikacion:

**01** **ID e shfrytëzuesit** (dhënë nga zyrtari i bankës) dhe shkruani **SMS-in** e pranuar si fjalëkalim




**02** Shkruani **PIN-in** e pranuar me **SMS në telefonin tuaj**



Tek **hapi i 4-të** ju duhet të caktoni një fjalëkalim që duhet të ketë **6** ose më së shumti **12 shkronja.** Pasi të jeni kyçur në **TebMobile** do t'ju shfaqet **kryefaqja**. Në të cilën **mund të kontrolloni bilancin tuaj dhe këstin e kredit kartelës**, si dhe keni **dy meny** më të përdorurat **Paguaj faturën, detaje.**

**03** Zgjidh opsionin për **PIN-in** tuaj **SMART KEY**




**04** Shkruaj **PIN-in** e dhënë nga banka **(fjalëkalimin e vjetër)** dhe caktoni fjalëkalimin e ri



05 Kyçja në TEB Mobile




# SHËNIM:

Duhet të keni parasysh që fjalëkalimi juaj skadon çdo **90 ditë.**

Hapat e njëjtë si më sipër duhet të ndiqen për të ndryshuar fjalëkalimin çdo herë.



# 2.Monitorimi i Llogarive

- Në **meny-në Llogaritë** do të mund të menaxhoni **të gjitha llogaritë** të cilat ju i keni në **Bankën TEB.**
- Në këtë meny ju mund të monitoroni:
  - **Llogaritë tuaja në TEB bankë**
  - **Gjendjen e llogarisë tuaj deri në 3 muajt e fundit**

**01** Kryefaqja

**02** Llogaritë

**03** Gjendja e llogarisë për tre muaj











# 3.Kredit Kartela
(Starcard, She card, Premium Starcard, Agro Card)

Në meny menaxhoni **Kredit Kartelën** tuaj mund t'i kryeni të gjitha shërbimet bankare online:

- Monitoroni **Kredit Kartelën**
- Paguani këstin e kredit kartelës
- Aplikoni për **Kredit Kartelë, Aplikoni për rritjen e limitit** të kredit kartelës
- Ndryshoni metodën e dërgimit të gjendjes për **Kredit kartelë**
- Regjistroni shërbimin për Blerje me këste jashtë vendit
- Ndryshoni ciklin e pagesave

01 Zgjedh "paguaj borxhin"

## Pagesa e Kredit Kartelës

Në TebMobile mund të kryeni obligimet kreditore të kredit kartelës përmes llogarisë tuaj. Në menynë **Kredit kartela,** duhet të klikoni në opsionin ku shfaqen detajet e gjendjes së kredit kartelës dhe opsionet e pagesës: **Borxhi i mbetur, borxhi minimal dhe shumë tjetër.** Zgjedh opsionin e shumës që do të paguani dhe klikoni në **Paguaj** që pagesa të kryhet.



**02** Zgjedh shumën të cilën do të paguani




**03** Konfirmimi i të dhënave




**04** Shkruani e-mail valid **për faturë**



# Aplikoni për Rritje të Limitit

Në TebMobile ju mund të aplikoni për rritje të limitit të kredit kartelës. Në menynë e Kredit Kartelave duhet të zgjedhni opsionin "TJERA" dhe aty do t'ju shfaqen disa opsione. Opsionin të cilin duhet të zgjedhni është **Apliko për rritje të limitit**. Pasi të jepni të dhënat e juaja do të njoftoheni nga dega për aprovimin e limitit të Kredit Kartelës.

**01** Apliko për rritje limiti




**02** Jepni të dhënat tuaja




**03** Konfirmimi i të dhënave



# Apliko për Kredit Kartelë

Në menynë e Kredit Kartelës duhet të zgjedhin opsionin "TJERA" ku do t'ju shfaqet **Apliko për Kredit Kartelë (Starcard).**
Në këtë opsion do t'iu shfaqet dritarja ku duhet të jepni të dhënat tuaja. Pasi të keni plotësuar të gjitha të dhënat duhet të klikoni në "VAZHDO". Pas aplikimit do të informoheni nga dega juaj për aprovimin e kredit kartelës tuaj.

## 01 Të dhënat e kartelës




## 02 Përfundimi i aplikimit



# Ndryshimi i metodës së dërgimit të gjendjes për kredit kartelën tuaj

Përmes opsionit **"Ndryshimi i metodës së dërgimit të gjendjes për Kredit Kartelën tuaj"** ju do të mund të aktivizoni shërbimin, i cili iu mundëson dërgimin e gjendjes së kredit kartelës falas në e-mail adresën tuaj. Klikoni në menynë e kredit kartelës dhe zgjedh opsionin "TJERA". Në atë opsion mund të klikoni "Ndrysho metodën e dërgimit" dhe ju shfaqet dritarja e zgjedhjes së metodës që dëshironi t'ju dërgohet gjendja.

**01** Meny Kredit kartela

**02** Ndrysho metodën e dërgimit

**03** Zgjedhja e metodës









## Blerje me këste jashtë vendit

Shërbimi **"Blerje me këste jashtë vendit"** iu mundëson klientëve që pagesat e tyre jashtë vendit t'i realizojnë me këste.
Pagesat jashtë vendit mund të ndahen deri në 3 këste.
TebMobile iu mundëson që ju të regjistroni këtë shërbim para se të udhëtoni jashtë shtetit pa vizituar degën.
Gjithashtu përmes TEB mobile mund të bëni edhe ç'regjistrimin e shërbimit.

01 Meny Kredit kartela



## 02 Blerje me këste jashtë vendit




## 03 Info për blerje jashtëvendit dhe Regjistrim




## 04 Shkruani e-mail valid **për faturë**





# 4.Monitorimi i kredisë

Në këtë meny TebMobile ju mundësohet Monitorimi i Kredisë. Përmes kësaj meny-je ju mund të kryeni shërbime bankare online si:

- **Aplikim për kredi**
- **Monitorimi i kredisë**
- **Monitorimi i planit/detajeve të pagesës së kredisë**

01 Kërkesat për kredi

## Aplikim për kredi

Përmes TebMobile ju mund të aplikoni për kredi ose mbitërheqje duke plotësuar të dhënat e sakta.

Pasi të keni aplikuar ju do të informohen nga dega juaj për kushtet e tjera të cilat duhet të plotësohen për të përfunduar aplikimin.



**02** Të dhënat personale

**03** Konfirmimi i aplikimit

**04** Aplikacioni është pranuar









# Monitorimi i planit të pagesës

Përmes kësaj meny-je ju mund të monitoroni planin e pagesës të obligimeve tuaja kreditore: **Pagesat institucionale, Shërbimet e parapaguara (TV, Internet), SMS-Top-up, Mbushje të telefonit.**








# 5.Pagesat

Të gjitha pagesat institucionale, shërbimet e parapaguara (TV, internet), SMS top-up, mbushje të telefonit mund t'i kryeni përmes TebMobile shpejt dhe sigurtë.

## Skeno dhe paguaj

Përmes aplikacionit TebMobile keni mundësi unike për **pagesën e faturave tuaja.**

Në meny-në **Pagesat** ju zgjedhni opsionin **skeno dhe paguaj** ku do ju hapet dritarja për të **skenuar barkodin e faturës të KESCO.**
Pasi të keni skenuar, të gjitha të dhënat regjistrohen.
Rishikoni të dhënat para se të egzekutoni pagesën.

**01** Nga Meny kryesore, zgjedh Pagesat



**02** Skeno dhe paguaj




**03** Skenimi i barkodit




**04** Të dhënat e faturës



## Pagesat Institucionale

Pagesat institucionale të cilat mund t'i kryeni përmes TebMobile janë

- **Uji,**
- **Rryma Elektrike,**
- **Sigurimi,**
- **Dogana,**
- **Ngrohtorja,**
- **Tarifa Edukimi,**
- **Tjera**




## Pagesat e Kolektorëve

Pagesat e kolektorëve të cilat mund t'i kryeni përmes TebMobile janë:

- **Komisionet,**
- **Organet publike,**
- **Edukim,**
- **Zyrat dhe Agjensionet Shtetërore,**
- **Organizata Publike dhe Private,**
- **Komunat,**
- **Ministria,**
- **Tjera**

# Shembull i Pagesave Institutcionale - Pagesa e Doganës

**01** Zgjedh llogarinë dhe opsioni e doganës

**02** Shkruani numrin e referencës dhe Shumën e pagesës

**03** Konfirmimi i të dhënave









# Shembull i Pagesave të Kolektorëve - Pagesa e Ministrisë

**01** Zgjedh llogarinë dhe Institucionin Ministria, pastaj Kompaninë. Shkruani Numrin Serik, UNIREF dhe shumën.




**02** Konfirmimi i të dhënave tuaj.



# Shërbimet e parapaguara

Përmes TEB mobile në këtë opsion ju mund të paguani të gjitha shërbimet e parapaguara të IPKO-së

**01** Zgjedh shërbimet e parapaguara




**02** Të dhënat e shërbimit



**03** Konfirmimi i të dhënave




**04** Pagesa është kryer me sukses



# Mbushje e Telefonit përmes Debit Card/Starcard

Në TebMobile mund të bëni mbushjen e telefonit tuaj nga limiti i kredit kartelës (Starcard). Në meny-në e pagesave zgjedhni opsionin **Mbushje.**
Pastaj duhet të zgjedhni llogarinë Starcard prej cilës do të paguhet mbushja, duhet te zgjedhni operatorin, prefiksin, të shkruani numrin tuaj apo numrin të cilin dëshironi ta dërgoni mbushjen. Duke klikuar në butonin vazhdo ju validoni kërkesën tuaj për mbushje telefonike.

**01** Zgjedh llogarinë nga e cila do të paguani

**02** Jep të dhënat

**03** Konfirmimi i të dhënave









# SMS-Top up mbushje

Përmes TebMobile ju mund të aktivizoni shërbimin "SMS-top up mbushje" pa pasur nevojë të vizitoni degën tuaj. Shërbimi është funksional **24/7 dhe është falas** për t'u aktivizuar.

**01** Regjistro Limitin e ri

**02** Shkruani të dhënat

**03** Operacioni është realizuar











# 6.Transfere

Përmes aplikacionit TebMobile keni mundësi që të realizoni transferet tuaj brenda bankës TEB dhe në të gjitha bankat vendore në Kosovë. Në menynë kryesore ju zgjedhni opsionin "Transferet" ku do të shfaqen opsionet që ju mund t'i përdorni për transfere:

- **Transfere të shpeshta**
- **Transfere brenda llogarive tuaja**
- **Transferet brenda llogarive TEB**
- **Transferet ndërmjet bankave tjera**

01 Kliko në Transferet ndërmjet llogarive të mija

## Transfer ndërmjet llogarive tuaja

Në këtë meny mund të bëni transfere nga të gjitha llogaritë të cilat i keni në bankën TEB.

Siç janë llogaria rrjedhëse, llogaria e kursimeve, llogaria e valutave (USD, GBP, CHF).

Për të realizuar një transfer ndërmjet llogarive tuaj duhet të zgjedhni opsionin "Ndërmjet llogarive të mia".



**02** Zgjedh llogaritë dhe plotëso të dhënat




**03** Transferi u krye me sukses



# Transfere në llogaritë e TEB-it

Përmes këtij opsioni **"Në Llogaritë e TEB-it"** mund të bëni transfere tek personat të cilët janë klientë të bankës TEB. Duke shkruar të dhënat e sakta të llogarisë të përfituesit në të cilën transferoni mjetet tuaja.

**01** Në llogaritë e TEB-it

**02** Të dhënat e llogarisë pranuese






**02** Konfirmimi i të dhënave




**03** Transferi u krye me sukses



# Transfere në bankat vendore

Përmes TebMobile mund të bëni transfere në bankat e tjera vendore. Në meny-në **transfere** duke e zgjedhur opsionin **"Në banka të tjera"** dhe duke shkruar të dhënat tuaja të sakta, realizohet transferi.

**01** Opsioni në banka të tjera

**02** Të dhënat personale

**03** Konfirmimi i të dhënave të transferit dhe të dhënat e pranuesit











# 7.Pagesa automatike

Për të lehtësuar pagesat tuaja të shpeshta TebMobile ju mundëson aktivizimin e **Urdhër Pagesave Automatike.** Të gjitha pagesat automatike mund të realizohen përmes llogarisë apo kredit kartelës tuaj (Starcard). Për të aktivizuar këtë shërbim duhet të klikoni në meny-në **Pagesat Automatike.**

## KRIJO PAGESËN AUTOMATIKE

**01** Krijo pagesën automatike

**02** Vazhdo pa zgjedhur






**04** Konfirmimi i të dhënave

**03** Plotëso të dhënat






## Shiko pagesën automatike

Në këtë opsion shfaqen të gjitha "Pagesat Automatike" të cilat i keni aktivizuar dhe mund t'i menaxhoni më lehtë.

Përmes këtij opsioni ju mund të kontrolloni **detajet e pagesave, modifikoni** si dhe të bëni **anulimin** e tyre.





# 8.Investime

Një veçori që **TebMobile** ka janë shitja dhe blerja e valutave të cilat i ka banka **TEB (USD, GBP, CHF).** Për të përdorur këtë opsion fillmisht duhet të keni llogarinë **EUR** dhe llogarinë e valutës së huaj **(USD, GBP, CHF)** për të bërë **blerjen ose shitjen e valutave.**

## BLERJE E VALUTËS

**01** Zgjedh llogarinë të cilën do të konvertoni valutën dhe Shumën




**02** Të dhënat për kursin e këmbimit shumën në valutën e blerë





# SHITJA E VALUTËS

**01** Zgjedh llogarinë që do të konvertoni valutën dhe Shumën




**02** Të dhënat për kursin e këmbimit shumën në valutën e blerë





# 9.Informata personale

Kjo meny përmban një opsion për **Verifikimin e Numrit Mobil**. Përmes këtij opsioni, ju mund të validoni/verifikoni numrin tuaj mobil në mënyrë që banka për shkaqe sigurie do të mund të ju kontaktojë në numrin e verifikuar nga ju. Po ashtu numri i verifikuar shërben edhe për shërbimin "3D Secure" blerje online.

**01** Kliko në opsionin Verifikimi i numrit




**02** Shkruani numrin tuaj që po verifikoni



03 Shkruani kodin e dërguar me SMS në telefonin tuaj




04 Ndryshimi është kryer me sukses



# BANKËN N'XHEP
# ME TEBMOBILE

ANDROID APP ON
Google play

Download on the
App Store

www.teb-kos.com

www.teb-kos.com